



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2694/7 prot.

Datë 05/12/2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1259/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05/12/2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK në procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur” me Nr. REF-78603-08-29-2023, me objekt “Pyllëzime me Akacie” me fond limit 28,333,333 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 26.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Trade and Construct Group” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK me NIPT: K83725201G dhe adresë: *Ura e Gjolës, Nr. Pasurie 421/6, Zonë kadastrale 1299, Bubq, Durrës.*

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit  
*Adresa: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina nr. 20, Tiranë.*

**Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Trade and Construct Group” SHPK me NIPT: M11320022Q dhe adresë: *Rruga “Marko Boçari”, Pallati “TID”, Shkalla 1, Ap.3, Tiranë.*

Operatori ekonomik “Kurora” SHPK me NIPT: J76314803S dhe adresë: Lagja “Sporti”, Pallati i ri pranë Kishës Ortodokse, Gramsh.

Operatori ekonomik “Albgarden” SHPK me NIPT: K37513520N dhe adresë: Lagja “Skënderbeg”, godinë private 1 katëshe në superstradën Lezhë – Shkodër, Km 1, Lezhë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.08.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-78603-08-29-2023, me objekt “Pyllëzime me Akacie” me fond limit 28,333,333 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 26.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Më datë 26.09.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 24.10.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Kurora” shpk	20.920.000 leke	skualifikuar
2. “AlbGarden” shpk	24.418.104 leke	skualifikuar
3. “A.M.E 2020” shpk	25.498.000 leke	skualifikuar
4. “Trade and Construction Group” shpk	27.894.830 leke	kualifikuar

II.4. Në datën 24.10.2023, operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

*“Nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi për plotësimin e kësaj pike OE A.M.E Sh.p.k ka paraqitur 2 kontrata dhe 18 fatura tatimore të realizuara gjatë 3 viteve të fundit, konkretisht:*

- a) *Kontrata me nr. 7275/8 prot., datë 13.11.2020 me objekt “Blerje pemë dekorative” lidhur me bashkinë Durrës në vlerën 8,200,000 leke pa tvsh. Nga shqyrtimi i preventivit të kësaj kontrate, rezulton se zerat që përmban ky preventiv, kanë të bëjnë me blerje malli (bimësi dekorative) dhe jo me punime në fushën pyjeve, objekt i kësaj procedure prokurimi. **Për këtë arsye kjo kontratë nuk vlersohet si kontratë e ngjashme me objektin e këtij prokurimi.***
- b) *Kontrata me nr. 590/10 prot., datë 02.07.2021 me objekt “Mirëmbajtje e ambienteve të brendshme dhe tarracës për OSHEE Grup Sh.a dhe për Drejtorin Rajonale Tiranë OSSH Sh.a”, lidhur me Drejtorinë Rajonale Tiranë/OSSH Sh.a, nuk vlersohet si kontratë e ngjashme për shkak se zerat e preventivit të kësaj kontrate lidhen me shërbime mirëmbajtje dhe jo me punime në fushën pyjeve, objekt i kësaj procedure prokurimi.*

*Faturat tatimore të shitjes të realizuara në sektorin privat, përmbajnë zera e artikujve të llojit mall, respektivisht (a) lule, (b) kaktus, (c) fikus, (d) vazo, (dh) pleh ushqyes dhe nuk përmbajnë punime në fushën e pyjeve, objekt i kësaj procedure prokurimi. **Për këtë arsye këto fatura tatimore nuk vlersohen si kontrata të ngjashme me objektin e këtij prokurimi.**”.*

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet se më datën 31.10.2023 autoriteti kontraktor publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “Trade and Construction Group” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 06.11.2023, operatori ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK ka paraqitur ankesë, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të

sipërcituar, si dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “*Trade and Construction Group*” SHPK, si dhe lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomikë “*Kuora*” SHPK dhe “*AlbGarden*” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2694/2 prot, datë 07.11.2023.

II.8. Në datën 13.11.2023 operatori ekonomik “*Trade and Construction Group*” SHPK, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik Formularin e paraqitjes së Argumentave, në lidhje me procedurën e prokurimit object ankimi.

II.9. Me shkresën nr. 1929/3 prot, datë 13.11.2023 me objekt: “*Kthim përgjigje*”, protokolluar me tonën me nr. 2694/4 prot datë 15.11.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*A.M.E 2020*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, ku ndër të tjera ka argumentuar se: “*...Në përfundim Kontrata e shërbimit me nr. 591/10 prot., datë 02.07.2021, , me vlerë 7.458.680 lek, pa TVSH, dhe kontrata me nr. 7275/8 prot., 13.11.2020, me vlerë 8.200.000, pa TVSH, duhej të konsideroshin si punë të ngjashme nga KVO.*

*Gjithasi duke patur parasysh se fondi limit i procedurës së prokurimit me objekt “Pyllëzim me akacie”, është 28.333.333 lekë, 50% i saj është 14.166.667 lekë vërejmë se kriteri 2.3.1 i DST rezulton të mos jetë përmbushur nga OE shoqëria A.M.E 2020 shpk.*

*Si dhe nëse e bashkojmë vlerën e dy kontratave të ngjashme dhe konkretisht 7.458.680 me 8.200.000 me një shumatore prej 15.658.680 lekësh nuk i plotëson kushtet e dyfishit të vlerës limit të kontratës që prokurohet e cila duhet të ishte  $28.333.333 \times 2 = 56.666.666$  lekë duke të çuar kështu në përfundim se kriteri 2.3.1 i DST rezulton të mos jetë përmbushur nga OE shoqëria A.M.E 2020 shpk dhe oferta bëhet e pakualifikueshme.*

*Sa më sipërpretendimet e ankimuesit për kualifikimin e tij si shoqëri me ofertë të vlefshme pranohen pjesërisht dhe konkretisht vetëm për njohjen e dy kontratave si punë të ngjashme por që në tërësi nuk përmbushin kriteret e vendosura për punët e ngjashme dhe rrjedhimisht oferta e paraqitur nga OE shpk shoqëria A.M.E 2020 nuk plotëson kushtet për të qënë e vlefshme.”.*

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga dy subjektet e tjera të interesuara operatori ekonomik “*Kurora*” SHPK dhe operatori ekonomik “*AlbGarden*” SHPK subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, të ligjit Nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*.”

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

### **Arsyeton**

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "A.M.E 2020" SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij se: "Nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi për plotësimin e kësaj pike OE A.M.E Sh.p.k ka paraqitur 2 kontrata dhe 18 fatura tatimore të realizuara gjatë 3 viteve të fundit, konkretisht:

a) Kontrata me nr. 7275/8 prot., datë 13.11.2020 me objekt "Blerje pemë dekorative" lidhur me bashkinë Durrës në vlerën 8,200,000 leke pa tvsh. Nga shqyrtimi i preventivit të kësaj kontrate, rezulton se zerat që përmban ky preventiv, kanë të bëjnë me blerje malli (bimësi dekorative) dhe jo me punime në fushën pyjeve, objekt i kësaj procedure prokurimi. Për këtë arsye kjo kontratë nuk vlersohet si kontratë e ngjashme me objektin e këtij prokurimi.

b) Kontrata me nr. 590/10 prot., datë 02.07.2021 me objekt "Mirëmbajtje e ambienteve të brendshme dhe tarracës për OSHEE Grup Sh.a dhe për Drejtorin Rajonale Tiranë OSSH Sh.a", lidhur me Drejtorinë Rajonale Tiranë/OSSH Sh.a, nuk vlersohet si kontratë e ngjashme për shkak se zerat e preventivit të kësaj kontrate lidhen me shërbime mirëmbajtje dhe jo me punime në fushën pyjeve, objekt i kësaj procedure prokurimi.

Faturat tatimore të shitjes të realizuara në sektorin privat, përmbajnë zera e artikujve të llojit mall, respektivisht (a) lule, (b) kaktus, (c) fikus, (d) vazo, (dh) pleh ushqyes dhe nuk përmbajnë punime në fushën e pyjeve, objekt i kësaj procedure prokurimi. Për këtë arsye këto fatura tatimore nuk vlersohen si kontrata të ngjashme me objektin e këtij prokurimi.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 7 "FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT", të dokumenteve të tenderit të "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", "Kapaciteti Teknik", pika 2.3.1 është parashikuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

*"Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*ose*

*Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar*

me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39 pika 5, neni 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

III.1.2. Në preventivin e ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi, si më poshtë:

## 5.5. PREVENTIVAT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E TIRANËS  
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

### PREVENTIV PËLLËZIMI ME "AKACIE" - (VITI I I)

Shenja e manualit	Përshkrimi i punimeve	Njësia e matjes	Volumi i punimeve
184-5	Pastrim drizash, ferrash etj: kur toka ka pak drunj e ferra.	m <sup>2</sup>	200 000
222-1	Pregatitje piketash.	copë	50 000
222-3	Piketim gropa në mal {2 punëtorë}.	copë	50 000
222-7	Hapje gropa 40x40x40cm, në toka mesatare.	copë	50 000
228-12	Transport fidanësh, fletorë 1-2 vjeçarë e lart {pa tokë}, me krahë, deri në objek 300 m largësi.	copë	50 000
220-21-b	Shtratëzim i fidanëve 1-2 vjeçar në tufa me nga 50 copë.	copë	50 000
220-24-b	Nxjerrje fidanësh nga shtratëzimi: fletorë.	copë	50 000
224-13	Mbjellje fidanash në gropa 40x40x40 cm.	copë	50 000
Analizë	<b>Bazë materiale, shpenzime transporti</b>		
	Blerje fidanësh Akacies.	copë	50 000
	Transport fidanësh fletorë me kafshë.	copë	50 000
	Transport i largët i fidanëve {Auto}.	ton-km	50 000
<b>SHUMA PA TVSH</b>			
<b>TVSH 20 %</b>			
<b>TOTALI I PREVENTIVIT</b>			

A Vendi i kryerjes së punimeve:

**EKONOMIA PYJORE "FAG":**

Parcela Nr. (10.a, 17.c, 28.a, 40.a, 140.a, 141.a).

**"ZEVËNDËSIM ME AKACIE DHE SHËRBIME SILVË - KULTURALE" - {VITI I II}**

Shenja e manualit	Përshkrimi i punimeve	Njësia e matjes	Volumi i punimeve
223-10	Rihapje gropash me madhësi 60 x 60 x 60 cm, e poshtë. {40 x 40 x 40 cm }.	copë	10 000
188-29	Transport fidanësh, fletorë 1-2 vjeçarë e lart {pa tokë} me krahë, deri në objek 300 m largësi.	copë	10 000
220-21-b	Shtratëzim i fidanëve 2-3 vjeçar në tufa me nga 50 copë.	copë	10 000
220-24-b	Nxjerrje fidanësh nga shtratëzimi: fletor.	copë	10 000
224-12	Mbjellje fidana në gropa 60 x 60 x 60 cm.	copë	10 000
228-1	Prashitje fidanesh {me shatë} në gropa me dimensione më pak se 80x80x80 cm, e rreze 0.5 m. {viti i II-të, 2 herë} 2x768.	Copë	50 000
229-7	Hedhje plehu kimik, rreth, fidanit në pyllëzime {viti II-të, 2 herë}.	Copë	50 000
229-8	Ujitje fidanash në pyllëzime me 30 litra ujë, mbi 100m larg	Copë	50 000
<b>SHUMA I</b>			
Analizë	<b>Bazë materiale, shpenzime transporti</b>		
	Blerje fidanësh Akacie.	copë	10 000
	Blerje plehu kimik .{Dap ose Nitrat}.	Kv	200
	Transport plehu kimik .{Dap ose Nitrat}.	Kv	80
	Transport fidanësh fletorë me kafshë.	copë	10 000
	Transport i largët i fidanëve {Auto}.	ton-km	10 000
<b>SHUMA II</b>			
<b>SHUMA PA TVSH</b>			
<b>TVSH 20 %</b>			
<b>TOTALI I PREVENTIVIT</b>			

**"SHËRBIME SILVË - KULTURALE NË AKACIE" - {VITI I III}**

Shenja e manualit	Përshkrimi i punimeve	Njësia e matjes	Volumi i punimeve
228-1	Prashitje fidanesh {me shatë} në gropa me dimensione më pak se 80x80x80 cm, e rreze 0.5 m. {viti i III-të, 2 herë} 2x768.	Copë	50 000
229-7	Hedhje plehu kimik, rreth, fidanit në pyllëzime {viti III-të, 2 herë}.	Copë	50 000
229-8	Ujitje fidanash në pyllëzime me 30 litra ujë, mbi 100m larg	Copë	50 000
<b>SHUMA I</b>			
Analizë	<b>Bazë materiale, shpenzime transporti</b>		
	Blerje plehu kimik .{Dap ose Nitrat}.	Kv	200
	Transport plehu kimik .{Dap ose Nitrat}.	Kv	80
<b>SHUMA II</b>			
<b>SHUMA PA TVSH</b>			
<b>TVSH 20 %</b>			
<b>TOTALI I PREVENTIVIT</b>			

III.1.3. Nga shqyrtimi i procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” konstatohet se hartimin dhe vendosjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit objekt ankimimi, autoriteti kontraktor i ka argumentuar si në vijim: “Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39 pika 5, neni 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik.”.

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratën me nr.prot 591/10, datë 02.07.2021, të lidhur nga ana e shoqërisë “A.M.E 2020” SHPK me Drejtorisë Rajonale Tiranë/OSSH sha, me objekt: “Mirëmbajtje e ambienteve të brëshme dhe e taracës për OSHEE Group sh.a dhe për Drejtorinë Rajonale Tiranë/OSSH sh.a.”, me vlerë 7.458.680 lekë pa-TVSH.

2. Kontratën me nr.prot 7275/8, datë 13.11.2020, të lidhur midis shoqërisë “A.M.E 2020” SHPK dhe Bashkisë Durrës, me objekt: “Blerje Pemë dekorative”, me vlerë 8.200.000 lekë pa-TVSH, me kohëzgjatje 30 ditë

- Kontratë Nr. 360/5 datë 28.06.2021 me vlerë 2.340.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 734/2022 me vlerë 1.500.500 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 359/2023 me vlerë 1.502.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 428/2023 me vlerë 1.301.500 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 485/2023 me vlerë 1.202.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 632/2023 me vlerë 2.000.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 297/2023 me vlerë 1.006.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 143/2023 me vlerë 843.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 578/2023 me vlerë 705.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 121/2023 me vlerë 503.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 268/2022 me vlerë 1.001.200 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 342/2022 me vlerë 1.121.500 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 378/2023 me vlerë 655.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 735/2022 me vlerë 2.014.500 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 275/2021 me vlerë 2.000.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 371/2022 me vlerë 3.082.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 426/2022 me vlerë 833.750 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 254/2023 me vlerë 805.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 244/2022 me vlerë 882.200 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 863/2022 me vlerë 348.200 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 885/2022 me vlerë 573.400 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 983/2022 me vlerë 1.068.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 159/2023 me vlerë 501.500 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 449/2023 me vlerë 300.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 485/2023 me vlerë 1.202.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 495/2023 me vlerë 112.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 576/2023 me vlerë 211.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 578/2023 me vlerë 705.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 609/2023 me vlerë 130.500 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 662/2023 me vlerë 117.600 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 669/2023 me vlerë 200.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 788/2023 me vlerë 137.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 830/2023 me vlerë 9.791.760 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 831/2023 me vlerë 525.600 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 132/30.12.2020 me vlerë 146.300 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 277/31.12.2020 me vlerë 3.000.000 lekë, me TVSH
- Faturë Nr. 278/31.12.2023 me vlerë 1.800.000 lekë, me TVSH

III.1.5. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes autoriteti kontraktor argumenton se: “... Në përfundim Kontrata e shërbimit me nr. 591/10



prot., datë 02.07.2021, , me vlerë 7.458.680 lek, pa TVSH, dhe kontrata me nr. 7275/8 prot., 13.11.2020, me vlerë 8.200.000, pa TVSH, duhej të konsideroshin si punë të ngjashme nga KVO.

Gjithasi duke patur parasysh se fondi limit i procedurës së prokurimit me objekt “Pyllëzim me akacie”, është 28.333.333 lekë, 50% i saj është 14.166.667 lekë vërejmë se kriteri 2.3.1 i DST rezulton të mos jetë përmbushur nga OE shoqëria A.M.E 2020 shpk.

Si dhe nëse e bashkojmë vlerën e dy kontratave të ngjashme dhe konkretisht 7.458.680 me 8.200.000 me një shumatore prej 15.658.680 lekësh nuk i plotëson kushtet e dyfishit të vlerës limit të kontratës që prokurohet e cila duhet të ishte  $28.333.333 \times 2 = 56.666.666$  lekë duke të çuar kështu në përfundim se kriteri 2.3.1 i DST rezulton të mos jetë përmbushur nga OE shoqëria A.M.E 2020 shpk dhe oferta bëhet e pakualifikueshme.

Sa më sipërpretendimet e ankimuesit për kualifikimin e tij si shoqëri me ofertë të vlefshme pranohen pjesërisht dhe konkretisht vetëm për njohjen e dy kontratave si punë të ngjashme por që në tërësi nuk përmbushin kriteret e vendosura për punët e ngjashme dhe rrjedhimisht oferta e paraqitur nga OE shpk shoqëria A.M.E 2020 nuk plotëson kushtet për të qënë e vlefshme.”.

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.8. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, në përmbushje të kriterit për punë të ngjashme të realizuara gjatë pesë viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, nga krahasimi faturave tatimore të shitjes dhe preventivave që shoqërojnë këto fatura, si dhe specifikimeve teknike të kontratave të sipërpërmendura, të realizuara operatori ekonomik, me preventivin, specifikimet teknike të objektit të prokurimit të dhëna në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik ankimes, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së projektit objekt të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar preventivit të punëve, pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në strukturën e shërbimeve autoriteti kontraktor ka parashikuar disa grupe shërbimesh me sasi dhe volume respektive.

Në rastin konkret, KPP gjykon, se nuk kemi të bëjmë me një projekt specifik, jo vetëm për sa i përket objektit të tij, por edhe natyrën e shërbimeve të kërkuara. Në këtë mënyrë, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me pyllëzimin dhe instalimin e një shoqërimi bimor pyjor në një mjedis apo zonë të caktuar, në të cilën instalimi i filizërisë në mënyrë natyrore është i pamundur. Ndërhyrja me punime për pyllëzimin e sipërfaqes prej 67.1559 ha, kurse në vitin 2023 do të realizojm pyllëzimin prej 20 ha, e cila aktualisht është pothuajse e zhveshur nga vegjetacioni pyjor, do të synojë në stabilizimin dhe mbrojtjen e objektit nga fenomeni i erozionit dhe gërryrjeve të tokës. Krijimi i një plantacioni me pyje të llojit akacie në objektin e propozuar, i cili krahas funksionit mbrojtës të tokës, do të ndikojë dhe në plotësimin e nevojave të komunitetit për lëndë drusore në të ardhmen, në menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, në përmirësimin e peizazhit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në afërsi të tij.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, **si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.** Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërkimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.** Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e dëshmimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë pesë viteve ë fundit nga data e njoftimit të kontraës, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushët me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i punëve të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e njoftimit të kontraëts, me një vlerë jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit është brenda periudhës pesëvjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 14 ë ligjit nr. 162/2020, datë 23 .12.2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë.

Lidhur me faktin nëse kontrata dhe faturat tatimore të dorëzuara nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK plotësojnë apo jo kriterin kualifikues të punëve të ngjashme do t’i analizojë në 3 (tre) komponentë kumulative dhe konkretisht komponenti i vlefshmërisë; komponenti i ngjashmërisë dhe komponenti i vlerës së realizuar.

Për sa i përket vlefshmërisë së faturave të dorëzuara, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se janë të vlefshme për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi, pasi këto fatura shitjeje janë të realizuara brenda afatit 5 (pesë) vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të kontratës dhe të faturave tatimore të shitjes, të vlefshme të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, KPP konstaton, se me anë të faturave tatimore të dorëzuara dëshmon, se ka kryer shërbime të natyrës së shitjes së mallrave dhe në asnjë rast nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për pastrim drizash, ferrash etj: kur toka ka pak drunj e ferra, pregatitje piketash, piketim gropash në mal, hapje gropash, transport fidanësh, shtratëzim i fidanëve 1-2 vjeçar në tufa, nxjerrje fidanësh nga shtratëzimi, mbjellje fidanash në gropa.

Komponentët e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi kërkojnë ekspertizë dhe eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga ankimesi me anë të kontratave të sipërcituara, pasi dhe vetë metodologjia e ndërtimit të saj është e ndryshme.

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë pune, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit ( ratio legis) të kërkesës **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie**. KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave të ngjashme dhe kontratës, duke nisur që nga objekti i tyre si dhe përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratës, rezulton se këto fatura dhe kontrata konsiderohet e ngjashme vetëm me zërin e bazë materiale në objektin e prokurimit, por për zërat e tjerë të preventivit, ku operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK ka marrë përsipër që të realizojë, nuk ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar shërbime të ngjashme.

Lidhur me komponentin e tretë, për sa i përket vlerës së faturave dhe kontratave të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se vlera e realizuar është më e madhe se sa kërkohet në kriterin kualifikues, por meqenëse kjo vlerë nuk është e ngjashme për të gjithë zërat e preventivit sikurse e trajtuam më sipër nuk ka peshë [për të vlerësuar nëse e plotëson apo jo kriterin kualifikues objekt-ankimi, pasi të treja kriteret janë kumulative në interpretim të kriterit kualifikues dhe për sa kohë këto fatura dhe kontrata nr. 360/5 date 28.06.2021 nuk janë të ngjashme, atëherë vlera e tyre nuk luan asnjë rol në plotësimin e këtij kriteri.

Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme,

pasi faturat dhe kontrata janë të ngjashme vetëm me njërin zë të preventivit, ndërkohë që për zërat e tjerë të preventivit të cilët janë komponentët kryesorë, nuk ka dëshmuar se ka realizuar shërbime të ngjashme, duke mos plotësuar këtë kriter kualifikues. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor dhe në raport me angazhimin që ka marrë përsipër të realizojë sipas kontratës së bashkëpunimit. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se faturat tatimore dhe kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.1 kapaciteti teknik.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “*Trade and Construct Group*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit më sipër, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK do të vijojë të mbetet e skualifikuar edhe pas ankimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-78603-08-29-2023, me

objekt “*Pyllëzime me Akacie*” me fond limit 28,333,333 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 26.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

2. Autoriteti kontraktor, lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**